



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

NR. 169, Datë 25.09.2019

PËR NDALIMIN E KANDIDIMIT TE KANDIDATIT PËR PROKUROR TË  
PËRGJITHSHËM

Në bazë të nenit 148/a të Kushtetutës, të nenit 166, pika 2 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar ,të nenit 22 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe te nenit 17/pika 4 të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të Z. Lulzim Alushaj për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Vendimit i bashkëngjitet raporti shpjegues, sipas nenit 17/4 të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë” i cili është pjesë integrale e këtij vendimi.
3. Të njoftohet për këtë vendim Z. Lulzim Alushaj.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 3 (tre) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI

GENT IBRAHIMI

ANËTAR

ARBEN DOLLAPAJ



ANËTAR

BESNIK CANI

ZV/KRYETARI

ALFRED BALLA

ANËTAR

BUJAR SHESHI



ANËTAR

VATE STAKA

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

KOSTAQ BELURI

ANËTAR

NURIHAN SEITI

ANËTAR

TARTAR BAZAJ

Më pakicë pjesërisht

ISHQIPTARIA.COM



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

RAPORT

PËR REZULTATET E VERIFIKIMIT TË KUSHTEVE LIGJORE NGA KANDIDATËT  
QË KANË SHPREHUR INTERES PËR POZICIONIN E PROKURORIT TË  
PËRGJITHSHËM

I

**Njoftimi dhe shpallja e vendeve vakante**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë është organi përgjegjës për përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Në këtë kuadër, Këshilli me vendimin nr.50 dt. 19.03.2019, miratoi rregulloren “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”. Rregullorja u botua në Fletoren Zyrtare nr. 44, më datë 29.03.2019 dhe ka hyrë në fuqi në të njëjtën datë.

Procesi i hartimit të Rregullores është mbështetur nga ekspertët e misionëve OPDAT dhe EURALIUS dhe i është nënshtuar diskutimit dhe konsultimit të detajuar nga ana e të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Menjëherë me hyrjen në fuqi të rregullores, më datë 29.03.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka shpallur ftesën për paraqitjen e shprehjeve të interesit për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë.

Në përfundim të afatit 30 ditor (në datën 29.04.2019), pranë Këshillit u regjistruan 4 (katër) kandidatë që shprehën interesin për të garuar për këtë pozicion. Në po këtë datë Këshilli publikoi në faqen e tij zyrtare emrat e kandidatëve, të cilët janë:

- Znj. Arta Marku
- Znj. Fatjona Memçaj
- Z. Lulzim Alushaj
- Z. Olsian Çela





## II

### **Afatet e verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve**

Bazuar në nenin 3/pika 4 të rregullores së lartpërmendur, Këshilli brenda 45 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të shprehjes së interesit nga kandidatët, kryen verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore që duhet të plotësojnë kandidatët për Prokuror të Përgjithshëm, bazuar në përcaktimet e nenit 22 të Ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” (Ligji për Prokurorinë) si dhe të nenit 4 të rregullores “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”.

Gjithashtu, në përcaktimet ligjore të sipërcituara përcaktohet se, Këshilli pret përfundimin e procedurave të rivlerësimit për kandidatët që i nënshtrohen këtij procesi deri në konfirmimin e tyre.

Në kushtet kur njëri nga 3 kandidatët magjistratë që shprehën interesin për të konkuruar për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm (Z. Olsian Çela), në datën e shprehjes së interesit, nuk e kishte kaluar procesin e rivlerësimit, në datën 08.05.2019, me shkresën nr. 397 Prot, Këshilli i është drejtuar zyrtarisht Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për të mundësuar rivlerësimin me përparësi të kandidatit në fjalë.

Sa më sipër, nisur nga fakti që pavarësisht shkresës së lartpërmendur, procesi i rivlerësimit për kandidatin Z. Olsian Çela nuk kishte përfunduar brenda afatit 45 ditor (afat i parashikuar nga ligji për përfundimin e procesit të verifikimit të plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët), Këshilli, me vendimin nr.109 dt.17.06.2019, vendosi të shtyjë afatin për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët në garë, deri në përfundimin e këtij procesi për kandidatin Olsian Çela.

Po në këtë vendim Këshilli vendosi që Kryetari i KLP-së të caktojë një grup pune për administrimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët dhe nga institucionet në kuadër të vlerësimit të plotësimit të kushteve ligjore për kandidim.

Me Urdhërin nr.32 dt. 18.06.2019 të Kryetarit të KLP-së, u caktua grupi i punës i përbërë nga:

- Z. Kostaq Beluri
- Znj. Nurihan Seiti
- Z. Vatë Staka



### III

#### **Kërkimi i informacionit për verifikimin e plotësisimit të kushteve ligjore nga ana e kandidatëve**

Me publikimin e emrave të kandidatëve në faqen zyrtare të KLP-së, Këshilli bazuar në nenin 31 të Ligjit Për Prokurorinë si dhe në nenet 4 dhe 14 të Rregullores, nisi dërgimin e kërkesave zyrtare për informacion institucioneve publike dhe private të parashikuara nga ligji si Shërbimi Informativ Shtetëror, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit Shtetëror, DSIK Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesit etj, për informacione të lidhura me kandidatët.

Këtë informacion Këshilli e kërkoi si për kandidatin Lulzim Alushaj i cili nuk është subjekt i procedurave të rivlerësimit dhe për tre kandidatët e tjerë, lidhur me informacione që mund të dispononin për fakte të ndodhura pas vendimit të organeve të rivlerësimit.

Institucionet i janë përgjigjur kërkesës së KLP-së duke përcjellë informacionin që ata dispononin për kandidatët.

Grupi i punës, i ngritur me urdhërin e lartpërmendur Kryetarit të Këshillit, gjatë administrimit të dokumentacionit të kandidatëve në garë, gjykoi se duhet t'i kërkohej dokumentacion shtesë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve lidhur me kandidatin Lulzim Alushaj. Mbi këtë bazë, Këshilli, me vendimin nr.121 dt.05.07.2019, vendosi t'i drejtohet institucionit në fjalë për të kërkuar informacion shtesë për kandidatin. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i është përgjigjur kërkesës së Këshillit për informacion shtesë, brenda 12 ditëve me shkresën nr.13683/1 dt.23.07.2019.

Pasi u mbyll cikli i korrespondencës me institucionet e tjera në kuadër të verifikimit të plotësisimit të kushteve ligjore për të kandiduar dhe u administrua dokumentacioni i dorëzuar nga kandidatët dhe nga institucionet, Këshilli nuk ndërmori veprime të mëtejshme për vlerësimin paraprak të plotësisimit ose jo të kushteve, por priti përfundimin e procedurave ligjore të rivlerësimit për kandidatin, Z. Olsian Çela.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit konfirmoi në detyrë Z.Çela, me vendimin nr.185 dt. 23.07.2019. Ky vendim u zbardh nga KPK me date 4 shtator 2019. Vendimi në fjalë nuk u ankimua nga Institucioni i Komisionerit Publik deri në përfundim të afatit ligjor për ankimin, duke marrë kështu formë të prerë më datën 23.09.2019.

Në këtë datë, anëtarëve të Këshillit ju shpërndanë dokumentat justifikuese të depozituara në Këshill nga vetë kandidatët dhe nga institucionet, të cilat shërbejnë për të vlerësuar plotësimin e kushteve ligjore nga ana e kandidatëve që kanë shprehur interesin për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.





#### IV

#### Vlerësimi paraprak i plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët

Anëtarët e Këshillit pasi u njohën me dokumentacionin e vënë në dispozicion, vijuan procedurën e vlerësimit paraprak duke shprehur qëndrimin e tyre lidhur me plotësimin ose jo të kushteve nga kandidatët nëpërmjet plotësimit të formularit ndihmës të hartuar për këtë qëllim. Pas konsultimit të dokumentacionit, secili prej anëtarëve të Këshillit, në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri, dorëzoi formularin ndihmës në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në datën 25.09.2019.

Nga rezultatet e verifikimit paraprak rezulton sa më poshtë:

1. Kandidati **Lulzim Alushaj** nuk plotëson kushtet ligjore për të vijuar garën për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë. Konkretisht, nga studimi i dokumentacionit të paraqitur nga aplikanti rezultoi se:

- **Kandidati nuk plotëson kushtin e pasjes 15 vjet përvijë pune si jurist i spikatur**, të parashikuar në nenin 148/a pika 3 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe nenin 4 të Rregullores “Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”.

Siç rezulton nga kopja e diplomës e depozituar nga kandidati, Z. Alushaj është diplomuar në drejtësi në Universitetin e Bologna në **15 qershor 2004**. Në këto kushte, deri në datën 29 prill 2019 (datë kur janë paraqitur shprehjet e interesit nga kandidatët) kishin kaluar më pak se 15 vjet nga dita e diplomimit të kandidatit Alushaj. Po kështu, duke ju referuar precedentit të vendosur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në interpretimin e konceptit “përvijë pune” në procesin e shqyrtimit të kandidaturave për prokurorë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, rezulton se, bazuar në legjislacionin e punës në Republikën e Shqipërisë, Këshilli ka konsideruar “përvijë pune” vetëm ato periudha gjatë të cilave kandidati ka pasur një kontratë të rregullt punësimi dhe për të cilat janë paguar rregullisht tatimet dhe/ose sigurimet e detyrueshme shoqërore e shëndetësore.

Edhe dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidati bashkë me shprehjen e interesit për kandidim tregon se Z. Alushaj arrin të provojë punësim vetëm për periudhën **shkurt 2005 e në vazhdim**.

- **Kandidati nuk ka depozituar vetëdeklarimet** për plotësimin e kushteve ligjore të përcaktuara në nenin 148/a pika 3 e Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” si dhe nenin

4/pika 2/a),b) të Rregullores“Për kriteret dhe procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve për Prokuror të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë”.

2. Kandidatet **Arta Marku, Fatjona Memçaj dhe Olsian Çela**, bazuar në dokumentacionin e administruar nga Këshilli, rezultojnë që i plotësojnë kushtet ligjore për të vazhduar garën e mëtejshme për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.

V

**Miratimi i listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore si dhe e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet ligjore**

Në përfundim të procesit të vlerësimit paraprak për plotësimin e kushteve ligjore nga kandidatët, Këshilli vendosi përjashtimin nga gara të kandidatit Lulzim Alushaj dhe vazhdimin e garës për kandidatët Arta Marku, Fatjona Memçaj dhe Olsian Çela.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETARI**  
**GENT IBRAHIMI**



**ZV/KRYETARI**  
**ALFRED BALLA**

**ANËTAR**  
**ARBEN DOLLAPAJ**

**ANËTAR**  
**BESNIK CANI**

**ANËTAR**

**BUJAR SHESHI**

**ANËTAR**  
**VATE STAKA**

**ANËTAR**  
**KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR**

**NURIHAN SELTI**

**ANËTAR**  
**SANDËR BECI**

**ANËTAR**  
**TARTAR BAZAJ**